REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LUSHNJE

Nr.8709 prot.

Lushnje, më 14/09/2026

RELACION

PËR NË KËSHILLIN BASHKIAK

PËR BASHKËFINANCIMIN DHE NJË SHTESË NË BUXHETIN E BASHKISË LUSHNJE PËR PROJEKTIN "SMART OLIVE"

Në kuadër të Thirrjes për Aplikime nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit, për Skemën **"Mbështetje për fuqizim të kapaciteteve menaxhuese të bashkive nëpërmjet aplikimit të skemave të granteve, Faza II"**, Bashkia Lushnje ka paraqitur projektin **"SMART OLIVE"**, me qëllim zhvillimin e një modeli të bujqësisë inteligjente dhe forcimin e kapaciteteve të fermerëve dhe institucioneve lokale. Aplikimi u krye më datë **14.07.2026** dhe kohëzgjatja e projektit është parashikuar **12 muaj**.

Projekti synon krijimin e një **rrjeti inteligjent monitorimi agro-klimatik në 15 njësitë administrative të Bashkisë Lushnje**, duke përdorur sensorë inteligjentë, teknologjinë IoT, dronë, inteligjencën artificiale dhe mjete të bujqësisë së precizionit.

Bashkia Lushnje është një nga zonat me potencialin më të madh bujqësor në vend dhe bujqësia përbën një sektor të rëndësishëm të ekonomisë lokale. Projekti "SMART OLIVE" synon të sjellë një qasje të re në menaxhimin e prodhimit bujqësor, përmes përdorimit të teknologjive moderne dhe marrjes së vendimeve të bazuara në të dhëna.

Në kuadër të projektit parashikohet:

- instalimi i një rrjeti sensorësh inteligjentë për monitorimin e temperaturës, lagështisë dhe mikroklimës;
- përdorimi i dronëve multispektralë dhe termikë për monitorimin e kulturave;
- hartëzimi i pjekurisë së ullirit;
- pajisja me makineri inteligjente për vjeljen e ullirit;
- zhvillimi/implementimi i një platforme dixhitale dhe aplikacioni mobil;
- trajnimi i fermerëve për përdorimin e teknologjive të reja;
- forcimi i kapaciteteve teknike të Bashkisë Lushnje dhe organizatave të fermerëve.

Projekti parashikon përfitime të drejtpërdrejta për fermerët, Shoqërinë e Bashkëpunimit Bujqësor **"Lushnje Olive Oil Union"**, organizatat e fermerëve dhe Bashkinë Lushnje, duke synuar rritjen e produktivitetit, uljen e kostove dhe përmirësimin e konkurrueshmërisë së prodhimit agro-ushqimor.

Sipas përmbledhjes financiare të projektit, vlera totale e tij është:

Burimi i financimit	Vlera
Financim nga FSHZH	**9,700,000 lekë**
Bashkëfinancim i Bashkisë Lushnje	**970,000 lekë**
Donatorë të tjerë	**0 lekë**
TOTALI	**10,670,000 lekë**

Bashkëfinancimi prej **970,000 lekë** lidhet me aktivitetin e **organizimit të trajnimeve me fermerët**, i cili në planin e aktiviteteve është parashikuar të financohet nga NJVV-ja.

Gjithashtu, në dokumentacionin e aplikimit Bashkia Lushnje deklaron se ka kapacitetin financiar për bashkëfinancimin e projektit të propozuar.

Për të garantuar realizimin e angazhimit financiar të Bashkisë Lushnje dhe për të mundësuar zbatimin e plotë të projektit, është e nevojshme që fondi prej **9,700,000 lekë** të parashikohet në buxhetin e Bashkisë Lushnje për vitin 2026, në zërin përkatës buxhetor, sipas klasifikimit ekonomik dhe funksional të miratuar.

Zbatimi i projektit "SMART OLIVE" pritet të sjellë një ndikim të rëndësishëm në zhvillimin ekonomik dhe bujqësor të territorit të Bashkisë Lushnje, duke:

- përmirësuar aksesin e fermerëve në të dhëna agro-klimatike në kohë reale;
- reduktuar përdorimin joefikas të ujit, plehrave dhe pesticideve;
- përmirësuar monitorimin dhe menaxhimin e kulturave bujqësore;
- rritur cilësinë dhe efikasitetin e prodhimit të ullirit;
- forcuar kapacitetet e fermerëve dhe strukturave të Bashkisë;
- nxitur transformimin dixhital të sektorit bujqësor;
- krijuar një model të qëndrueshëm të shërbimeve të përbashkëta për komunitetin bujqësor.

Investimi është konceptuar gjithashtu për të vijuar të funksionojë pas përfundimit të financimit, përmes angazhimit të Bashkisë, strukturave bujqësore dhe organizatave të fermerëve për administrimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës së krijuar.

DREJTORIA E PËRGJITHME E INTEGRIMIT, POLITIKAVE SOCIALE DHE INFORMIMIT

Ariola Korreshi

Adresa: Lagjia "Kongresi i Lushnjes" Tel:+355 35 222139 e-mail: bashkia_lushnje@yahoo.com

REPUBLIKA E SHQIPERISE
KËSHILLI BASHKIAK
LUSHNJE

Nr.8709/1 prot.

Lushnje, më 14 / 09 /2026

PROJEKT - VENDIM

Nr. 80 Datë 14/09/2026

PËR BASHKËFINANCIMIN DHE NJË SHTESË NË BUXHETIN E BASHKISË LUSHNJE PËR PROJEKTIN "SMART OLIVE"

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e tij të dates ___/___/2026 pasi mori në shqyrtim materialin e paraqitur nga Drejtoria e Integrimit, Politikave Sociale dhe Informimit "Për Miratimin e Bashkëfinancimit dhe Shtimin e Fondeve në Buxhetin e Bashkisë Lushnje për Projektin "Smart Olive", në mbështetje të ligjit Nr.139/2015 neni 54 gërma n "Për vetëqeverisjen Vendore", Ligjin Nr. 9936, datë 26.06.2008 neni 6, neni 15 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", Ligjin Nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", Ligjin Nr.68/2017 neni 6 gërma a, neni 10 "Për financat e vetqeverisjes vendore", Ligji Nr. 87/2025, "Për buxhetin e vitit 2026", me propozim të Kryetares së Bashkisë, Këshilli Bashkiak Lushnje,

PROPOZOJMË:

1. Miratimin e shtesës së fondit prej 9.700,000 lekë, si grant i Bashkisë për zbatimin e projektit "SMART OLIVE" të aplikuar në kuadër të skemës "Mbështetje për fuqizim të kapaciteteve menaxhuese të bashkive nëpërmjet aplikimit të skemave të granteve, Faza II".
2. Miratimin e bashkëfinancimit të Bashkisë Lushnje në shumën 970,000 (nëntëqind e shtatëdhjetë mijë) lekë, për zbatimin e projektit "SMART OLIVE", nga programet përkatëse të buxhetit.
3. Vlera totale e projektit "SMART OLIVE" është e përbërë si më poshtë:
   - Financim nga FSHZH: 9,700,000 lekë;
   - Bashkëfinancim nga Bashkia Lushnje: 970,000 lekë;
   - Vlera totale e projektit: 10,670,000 lekë.

4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Integrimit, Politikave Sociale dhe Informimit, në bashkëpunim me Drejtorinë e Financë–Buxhetit dhe Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Publike, Zhvillimit Urban dhe Rural të Bashkisë Lushnje.
5. Ky vendim hyn në fuqi **10 ditë pas shpalljes**.

Drejtoria e Përgjithshme e Integrimit,
Politikave Sociale dhe Informimit
Ariola Korreshi

Drejtoria Juridike
Bedri Hida

KRYETARI I BASHKISË
Eriselda Sefa

Adresa: Lagjia "Kongresi i Lushnjes" Tel:+355 35 222139 e-mail: bashkia_lushnje@yahoo.com